

Banka e Shqipërisë

ANALIZA E NDËRMJETËSIMIT FINANCIAR

T4 – 2011

ERJONA SULJOTI, SOFIKA NOTE
DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE

JANAR 2012


Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autoreve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.

P Ë R M B A J T J A

I.	BANKAT DHE NDËRMJETËSIMI FINANCIAR	4
I.1	ECURIA E NDËRMJETËSIMIT	5
I.2	KOSTOT E NDËRMJETËSIMIT	6
I.3	ECURIA E ELEMENTEVE JO-KOSTO NË NDËRMJETËSIM	8
II.	ZHVILLIMET NË DEPOZITA	9
III.	ZHVILLIMET NË KREDI	12

I. BANKAT DHE NDËRMJETËSIMI FINANCIAR


Aktiviteti ndërmjetësues gjatë tremujorit të fundit të vitit është zhvilluar në prani të ecurisë së ngadaltë, por në përmirësim, të aktivitetit ekonomik në vend, si dhe të pasigurive të shtuara në ekonominë e Eurozonës. Ecuria e aktivitetit ekonomik, ndjeshëm nën potencial, ka kushtëzuar përmirësimin e ngadaltë dhe jo të qëndrueshëm të portofolit të kredisë së bankave si dhe përkeqësimin e mëtejshëm të cilësisë së portofolit të kredisë. Në fund të tremujorit të tretë, raporti i kredive me probleme ndaj totalit të portofolit të kredisë shënoi 18%, përkundrajt 14% që shënonte në fund të vitit 2010. Në këto kushte, bankat kanë shtrënguar më tej standardet e kreditimit duke ndjekur politika të kujdesshme në kreditim. Ndërkohë, edhe kërkesa për financim nga bizneset vlerësohet të jetë e ulët, si pasojë e ekzistencës së kapaciteteve të pashfrytëzuara prodhuese. Pasiguria e lartë në zhvillimet e brendshme dhe ato jashtë vendit nxit hezitimin për të investuar, si tek bizneset dhe tek individët. Ndërkohë, gjatë tremujorëve të tretë dhe të katërt, shumë prej bankave të sistemit kanë shtuar kapital në përgjigje të plotësisimit të kërkesave rregullative. Në tërësi, vlerësohet se sistemi bankar është i mirëkapitalizuar dhe me likuiditet të kënaqshëm, duke qenë i aftë për të rritur ndërmjetësimin financiar.



Zhvillimet në depozita kanë qenë pozitive, të ndikuara nga preferenca e individëve për të përdorur më pak cash si dhe nga krijimi i parasë nga ndërmjetësimi i sistemit financiar. Stimuli i rritur fiskal në ekonomi gjatë tremujorit të fundit të vitit, së bashku me kërkesën e sektorit privat në financim, kanë ndihmuar në krijimin e parasë, sidomos në lekë. Në muajin nëntor,

raporti i depozitave ndaj PBB-së vlerësohet të ketë arritur në 68%, përkundrejt 64% në vitin 2010. Zhvillimet në depozita kanë pasqyruar edhe zhvendosjen e mjeteve monetare drejt instrumenteve më pak likuide. Për të njëjtën periudhë, paraja jashtë bankave ka rënë me rreth 1% krahasuar me fundin e vitit 2010. Forcimi i besimit në sistemin bankar, i shoqëruar me orientimin e agjentëve ekonomikë drejt instrumenteve afatgjata, ka çuar në rritjen e monetizimit të ekonomisë. Raporti i M3 ndaj PBB-se shënoi rritje të mëtejshme në 82%.


Aktiviteti ndërmjetësues i sistemit bankar në muajt tetor dhe nëntor ka ndjekur trendin ngadalësues të nisur që në muajin gusht. Raporti i kredisë ndaj depozitave arriti në 61.2% ose 2 pikë përqindje më pak se një vit më parë, i ndikuar nga rritja më e lartë e depozitave të sistemit dhe përmirësimi i ngadalhtë i kredisë për ekonominë. Kjo dinamikë është diktuar më shumë nga ngadalësimi i ndërmjetësimit në valutë, ndërkohë që ndërmjetësimi në lekë ka ardhur në rritje. Edhe ecuria e kostove të ndërmjetësimit sipas monedhave ka qenë e ndryshme gjatë kësaj periudhe. Ajo është rritur për monedhën vendase ndërsa ka rezultuar në rënie për monedhën euro. Analiza e kushteve të kreditimit tregon për shtrëngim të përgjithshëm të tyre në tremujorin e katërt të vitit, me një kontribut të rëndësishëm të elementeve jo-kosto.



I.1 ECURIA E NDËRMJETËSIMIT

Ndërmjetësimi në monedhën vendase në muajt tetor-nëntor është zhvilluar në linjë me ecurinë e muajve të mëparshëm të gjashtëmujorit të dytë të vitit, të karakterizuar nga një rritje e lehtë e raportit kredi/depozita. Në fund të muajit nëntor, ky raport qëndron në 40.3%, nga 39.9% dhe 39.3% që shënonte përkatësisht në fund të tremujorëve të tretë dhe të dytë të vitit. Një ecuri e tillë është diktuar nga vazhdimësia e rritjes më të shpejtë të kredisë në lekë, ndërkohë që depozitat në lekë kanë shfaqur norma të qëndrueshme të rritjes.

Ecuria e ndërmjetësimit në valutë në muajt tetor-nëntor ka vijuar tendencën e ngadalësimit, të nisur që në muajin gusht. Raporti kredi/depozita ka rezultuar 83.7% në të dy muajt, nga 84.5% dhe 88.3% që shënonte përkatësisht në fund të tremujorit të tretë dhe atij të dytë të vitit. Si depozitat në valutë, ashtu edhe kredia në valutë janë ngadalësuar në këtë periudhë, por ndikimi i kësaj të fundit ka qenë përcaktues i trendit rënës të treguesit të ndërmjetësimit në valutë.




I.2 KOSTOT E NDËRMJETËSIMIT

Kostoja e ndërmjetësimit në lekë ka shënuar rritje në muajt tetor dhe nëntor, ndryshe nga prirja rënëse e vërejtur në tre tremujorët e parë të vitit. Në muajin tetor-nëntor, ajo rezultoi 6.8 pikë përqindje, nga 6.3 pikë përqindje që shënonte mesatarisht në tremujorin e tretë. Rritja e koston së ndërmjetësimit ka ardhur kryesisht nga rritja e normës mesatare të interesit të kredisë, e cila në këtë periudhë regjistroi nivelin 11.8%, duke u rritur me 0.3 pikë përqindje në krahasim me vlerën e shënuar në tremujorin e tretë. Megjithë rritjen e pësuar në muajin nëntor dhe përtej luhatshmërisë mujore, norma e interesit të kredisë është në një trend rënës në dy vitet e kaluara. Në të njëjtën kohë, edhe norma mesatare e interesit të depozitave ka shënuar një rënie të lehtë në këta dy muaj, prej 0.16 pikësh përqindjeje, duke zbritur në nivelin 4.91% në muajin nëntor. Edhe pse e rritur në muajt në analizë, në terma mesatarë, kostoja e ndërmjetësimit është në nivele më të ulëta krahasuar me nivelet e gjashtëmujorit të parë të vitit dhe me ato të vitit të kaluar.

Pavarësisht rënies së yield-it të bonove të thesarit 12-mujore, të cilat përdoren si norma referencë për çmimin e kredisë në lekë, marzhi i aplikuar mbi to është rritur gjatë muajve tetor dhe nëntor, duke shkaktuar edhe rritjen e normës mesatare të interesit të kredisë. Diferenca mes normës së interesit të kredisë dhe yield-it të bonove 12-mujore të thesarit rezultoi 3.91 pikë përqindje dhe 4.85 pikë përqindje përkatësisht në këta dy muaj, kundrejt vlerës 3.39 pikë përqindje të regjistruar në muajin shtator.


Grafik 4. Ecuria e kostos së ndërmjetësimit në lekë*



*Marzhi llogaritet si diferencë mes normave të interesit të kredisë dhe atyre të depozitave. Spread-i llogaritet si diferencë mes normës së interesit të kredisë dhe asaj referencë (bono thesari 12-mujore për lekun dhe Euribor 12-mujor për euron).
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kostoja e ndërmjetësimit në euro¹ është shfaqur lehtësisht më e ulët në periudhën tetor-nëntor, në krahasim me tremujorin e dytë dhe atë të tretë të vitit. Në terma mesatarë, ajo rezultoi 4.79 pikë përqindje në këta dy muaj, ose rreth 0.16 pikë përqindje më e ulët se në tremujorin e tretë. Ecuria e saj ka ardhur si pasojë e rënies së njëkohshme të normës mesatare të interesit të depozitave dhe të asaj të kredisë, duke u ndikuar më shumë nga reduktimi i kësaj të fundit.

Grafik 5. Ecuria e kostos së ndërmjetësimit në euro.



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Çmimi i kredisë në euro vijon të jetë ndjeshëm më i lartë se normat referencë të kësaj monedhe në tregjet e huaja ndërbankare, duke faktorizuar koston e lartë të depozitave në euro në vend. Diferenca mes këtyre të fundit dhe normave euribor është rritur sërish duke filluar nga muaji gusht, në reflektim të politikës agresive të bankave për të tërhequr më shumë likuiditet në valutë.

¹ Veprimtaria e bankave në valutë është e dominuar nga aktiviteti i tyre në euro, i cili zë më shumë se 80% të aktivitetit në valutë.

Në muajt tetor-nëntor, kjo diferencë për maturitetin 12-mujor qëndron në mesatarisht 1.07 pikë përqindje. Ndërkohë, diferenca mes normës mesatare të interesit të kredisë dhe normave euribor ka rënë lehtë, duke rezultuar mesatarisht 5.19 pikë përqindje në këta dy muaj.

1.3 ECURIA E ELEMENTEVE JO-KOSTO NË NDËRMJETËSIM

Ecuria e ndërmjetësimit bankar, përveç normës së interesit, ndikohet edhe nga elemente jo-kosto të kreditimit, të cilët përcaktojnë ofertën për kredi. Nga analiza e aktivitetit kreditues në tremujorin e katërt të vitit vihet re një shtrëngim i mëtejshëm i kushteve të kreditimit, duke përdorur kryesisht elementet jo-kosto.




Kushtet e kreditimit për bizneset kanë vijuar të shtrëngohen në tremujorin e katërt të vitit 2012 dhe pritet të shtrëngohen më tej në tremujorin e parë të vitit 2012. Në kahun shtrëngues në tremujorin e fundit kanë vijuar të veprojnë të gjithë faktorët jo-kosto, me efekt të shtuar të maturitetit maksimal të kredisë dhe të kërkesave për kolateral. Ndërkohë, shtrëngimi i kushteve jo-kosto është shoqëruar edhe me rritje të komisioneve dhe një efekt lehtësues në rënie të marzhit për kreditë me rrezik mesatar.

Kushtet e financimit për individët, pasi u shtrënguan në tremujorin e tretë të vitit, mbetën të pandryshuara në tremujorin e katërt të tij. Në kahun lehtësues kanë vepruar vetëm elementet çmim të kredisë (marzhi mesatar, marzhit për kreditë me rrezik dhe komisionet). Ndër elementet jo-kosto, vijojnë të mbeten të shtrënguara kriteret për madhësinë e kredisë, kërkesat për kolateral dhe kërkesat për raportin e këstit të kredisë ndaj të ardhurave, ndërkohë që kriteri për maturitetin e kredisë ka dhënë një efekt neutral në ecurinë e kushteve të kreditimit për individët.


II. ZHVILLIMET NË DEPOZITA

Depozitat e sistemit bankar në muajin nëntor janë 12.7% më të larta se një vit më parë në terma nominalë. Gjatë vitit 2011, ritmet e rritjes vjetore të tyre kanë ardhur duke u ngadalësuar. Pastruar nga luajtjet e kursit, vihet re se norma vjetore e rritjes së depozitave është përmirësuar disi në muajt tetor –nëntor, duke arritur në 13.8%. Ndërkohë, flukset mesatare mujore përgjatë vitit 2011 janë rreth 20% më të ulëta, krahasuar me një vit më parë. Ngadalësimi i ritmeve të rritjes së depozitave ka reflektuar ecurinë e depozitave në valutë, të cilat u rritën mesatarisht me rreth 3.4 miliardë lekë në muaj, krahasuar me rreth 5.5 miliardë lekë në vitin 2010. Depozitat në lekë pasqyrojnë flukse më të larta krahasuar me një vit më parë. Ecuria e depozitave në lekë, krahas zhvendosjes drejt mjeteve me maturitet më të lartë, është ndihmuar edhe nga krijimi i parasë në monedhën vendase nga sektori publik dhe ai privat. Këto zhvillime kanë ndikuar në ruajtjen e strukturës sipas monedhave të depozitave. Raporti i depozitave në lekë ndaj depozitave totale qëndroi në të njëjtin nivel me një vit më parë, në 52%.

Sipas afateve, zgjerimi i depozitave është mbështetur nga ecuria e mirë e depozitave me afat në të dyja monedhat. Depozitat me afat janë rritur me rreth 15% krahasuar me një vit më parë, ndërkohë që ato pa afat janë rritur me 5%. Përgjatë vitit, ritmet e rritjes së depozitave me afat kanë ardhur duke u ngadalësuar, të ndikuara kryesisht nga ecuria e depozitave të bizneseve. Ecuria e mirë e depozitave me afat ka ndikuar në rritjen e raportit të tyre ndaj depozitave totale në 82% krahasuar me 79%, që ai shënonte një vit më parë. Ndërkohë, depozitat pa afat kryesisht janë ndikuar nga ecuria e depozitave të bizneseve në valutë.




Grafik 9. Ecuria e depozitave në valutë*



Depozitat pa afat shfaqën norma më të larta rritjeje në dy muajt e fundit, por, për shkak të peshës së vogël në strukturën e depozitave, ato kanë patur një ndikim të ulët në ecurinë e depozitave në valutë. Raporti i kredisë së depozitave pa afat ndaj totalit të depozitave në valutë arriti në 20.3%, rreth 2.3 pikë përqindje më pak se në dhjetor të 2010. Pesha e depozitave të individëve në valutë ndaj totalit të depozitave në valutë është rritur përgjatë vitit, duke kulmuar në 84% në muajin nëntor, krahasuar me 80 % që shënonte në fillim të vitit.

III. ZHVILLIMET NË KREDI²

Kredia për sektorin privat³ ka shfaqur një ecuri pozitive gjatë vitit 2011. Flukset neto mujore, të pastruara nga efekti i kursit të këmbimit kanë qenë mesatarisht 10% më të larta krahasuar me vitin 2010. Ndryshimi vjetor i tyre ka ndjekur një trend rritës, duke arritur në 14.0% në muajin tetor (12.7% pastruar nga efekti i kursit të këmbimit). Ndërkohë, në muajin nëntor, rritja vjetore e kredisë u reduktua në 10.9%. Ky ngadalësim i dedikohet kryesisht efektit bazë, të ardhur si rrjedhojë e rritjes së lartë të kredisë në muajin nëntor të vitit të kaluar dhe mbartjes së saj në normat vjetore të rritjes në muajt pasues. Në ndarjen sipas monedhës dhe kredimarrësit, ky efekt është i pranishëm në portofolin e kredisë në valutë për biznese.




Kredia në lekë në muajt tetor dhe nëntor ka vijuar të shfaqë një ecuri të mirë, si edhe në muajt e mëparshëm. Rreth 80% e zgjerimit të portofolit të kredisë për sektorin privat në këta dy muaj ka qenë në lekë. Rritja vjetore e saj ka rezultuar mesatarisht 17.6%, nga 16.9% dhe 15.6% që shënonte përkatësisht në fund të tremujorit të tretë dhe atij të dytë të vitit. Kreditimi në monedhë vendase ka shënuar norma vjetore në rritje, si për bizneset, ashtu edhe për individët. Pjesa më e madhe e zgjerimit të kredisë në lekë ka qenë në formën e kredisë për financimin e kapitalit qarkullues të bizneseve.

² Në analizën e kredisë të paraqitur në këtë seksion shifrat janë të pastruara nga kursi i këmbimit.

³ Kredia për sektorin privat përbën 97% të kredisë totale.

Rritja e preferencave për kreditim në lekë është prezente prej 2-3 vjetësh tashmë, nxitur kryesisht nga bankat në funksion të miradministrimit të rrezikut të kursit të këmbimit, por edhe nga ndërgjegjësimi i vetë kredimarrësve. Kjo sjellje është e dukshme në të gjitha llojet e kredive, por në mënyrë të veçantë në kredinë për investime të bizneseve dhe në atë hipotekare, të cilat tradicionalisht janë dominuar nga monedha të huaja. Si rrjedhojë, pesha e kredisë në lekë ndaj totalit të kredisë për sektorin privat qëndron në 37% në muajin nëntor, duke u rritur me rreth 2 pikë përqindje, kundrejt fundvitit të kaluar dhe me rreth 8 pikë përqindje kundrejt fundit të vitit 2008.



Rritja vjetore e kredisë në valutë për sektorin privat, pasi arriti nivelin më të lartë prej 10.5% në muajt gusht-shtator, u ngadalësua në 9.9% dhe 7.2% përkatësisht në muajt tetor dhe nëntor. Përveç efektit bazë të përmendur më lart, ky ngadalësim reflekton edhe ecurinë më të përmbajtur të këtij portofoli në dy muajt e fundit. Në përgjithësi, kredia në valutë gjatë vitit 2011 është zgjeruar më pak, në krahasim me vitin e mëparshëm dhe është shfaqur e luhatshme ndër tremujorë. Ajo ka patur një ecuri të mirë në tremujorin e parë dhe të tretë të vitit, ndërkohë që zgjerimi i saj ka qenë i ulët në tremujorin e dytë dhe në periudhën tetor-nëntor.

Burimi kryesor i rritjes së saj është kërkesa e bizneseve, ndërkohë që kreditimi në valutë për individët është i kufizuar. Krahas përjasjes së bankave edhe vetë individët po tregohen më të kujdesshëm në përdorimin e kredisë në valutë.

